

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Benet Beci ia dredh Ramës? Hyn e del i maskuar nga baza politike e Spiropalit në ish Bllok, qoka, afera, pastrim parash dhe dobësia për Pëllumb Gjokën
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/12/benet-beci-ia-dredh-rames-hyn-e-del-i-maskuar-nga-baza-politike-e-spiropalit-ne-ish-bllok-qoka-afere-pastrim-parash-dhe-dobesia-per-pellumb-gjoken/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:49:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	11 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 11 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 11 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b1eebd681a97aa50c10d80b28c4d1e64e7afddf3c34081635ace14eda688d408
TEKSTI	05a3991319e9cf13b3377a348b604f7dabcfa503362eeb69832e05201652eb95
PAMJA	150ae3ebca8559b30ca40921b50879398bb9a91f2256b91b2ae3bf1dc205d02d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a33d8cde1813be18fbaf24cb869f70fbd31d1dd96e90793b81f946d0e88d3476
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a33d8cde1813be18fbaf24cb869f70fbd31d1dd96e90793b81f946d0e88d3476>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Benet Beci ia drehd Ramës? Hyn e del i maskuar nga baza politike e Spiropalit në ish Bllok, qoka, afëra, pastrim parash dhe dobësia për Pëllumb Gjokën

Investigim

Publikuar: 12/09/2026

f X



Përpos Salillarit dhe personazheve me precedentë penalë, një nga njerëzit që frekuenton ditët e fundit më shpesh bazën politike të Elisa Spiropalit në ish Bllok është

kryebashkiaku i Shkodrës, Benet Beci, i pandehur nga SPAK për abuzime me tendera kur ishte drejtor i KESH-it. Benet Beci ngjit shpesh shkallët disi i maskuar për te baza e Spiropalit në ish Bllok dhe qëndron disa orë, duke 'sakrifikuar' kohën për punët e bashkisë.

Frekuentimi i zyrës së Spiropalit nga Benet Beci vjen në një kohë kur Spiropali ka përshkallëzuar rebelimin ndaj Edi Ramës, ndërsa është në rivalitet me Ditmir Bushatin dhe Pëllumb Piliçin për postin e kryeministrit të qeverisë teknike të ëndërruar.

Po çfarë e lidh Benet Becin me Elisa Spiropalin, e cila u rebelua ndaj Ramës pasi ky i fundit e shkarkoi si ministre të Jashtme?

Elisa Spiropali ishte caktuar nga Edi Rama si drejtuese politike e qarkut të Shkodrës, kur Beci kandidoi dhe u zgjodh kryebashkiak i Shkodrës në vitin 2023. Beci dhe Spiropali nuk i kursyen vlerësimet për njëri-tjetrin në publik. Çelësi i suksesit elektoral në zgjedhjet lokale të Benet Becit dhe Elisa Spiropalit në Shkodër besohet se ishte investitori strategjik, Pëllumb Gjoka, i arrestuar nga SPAK disa muaj pas zgjedhjeve 2023 për grup kriminal, korrupsion dhe sigurim i kushteve për vrasje.

Burime kanë theksuar se Beci dhe Spiropali paraqiteshin në mënyrë periodike para Pëllumb Gjokës, duke i raportuar për ecurinë e fushatës. Pas zgjedhjes së Becit kryebashkiak Pëllumb

Me te lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Doktoritë e përdorueshëm të Rrugës e Kosovareve dhe biznes shit-bleje pronash, deri pasqyruar në video



pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares



Historia e gjeneralit kroat të Bosnjes që vrau veten me helm në sallën e gjyqimit në



Udhëzoi në me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e ...



seanin e rrahjes. Pas zgjedhjes së Benet kryebashkiak, Rama Gjoka ka diktuar emërimin e disa drejtorëve në bashki, përfshirë edhe atë të IKMT-së. Gjoka besohet se është kryetari faktik dhe drejton nga burgu punët e Bashkisë Shkodër.

Ndërkaq, në vitin 2024, kur Rama e bëri kryetare të Kuvendit, Elisa Spiropali mori si këshilltar djalin e Benet Becit, Edon Beci, i cili më herët kishte punuar në Bankën e Shqipërisë. Vajza e Benet Becit, Edenja Beci, e cila investon paratë në kriptomonedha, është e punësuar tek Autoriteti i Aviacionit Civil.

Benet Beci dyshohet se ka pastruar dhe pastron paratë e korrupsionit kur ishte drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, KESH dhe aktualisht kryebashkiak i Shkodrës, përmes disa bizneseve formale në emrin e të birit dhe bashkëshortes Fitore Beci. Si Beci, ashtu edhe Spiropali kanë hapur kompani ndërmjetësimi shitblerje pronash në emër të familjërëve, duke qarkulluar qindra mijëra euro.

Benet Beci qëndron pas Tirana Training Center (TTC) me NIPT L72206048M, që ofron shërbime në fushën e arsimit, edukimit, trajnimeve dhe formimit profesional. Qendra administrohet nga bashkëshortja e Benet Becit, Fitore Beci, e bija Edenja Beci dhe i biri Edon Beci, duke qarkulluar para të dyshimta dhe donacione.

Benet Beci ka qarkulluar qindra mijëra euro edhe përmes bizneseve në emrin e gruas dhe të birit me niptet; M21709029H, L86805217R, L86805217R etj. Edon Beci, vitin e kaluar, vetëm nga biznesi i regjistruar si sekser ka deklaruar rreth 35 mijë euro të ardhura. Benet Beci posedon një pasuri me vlerë miliona euro, e cila dyshohet se është produkt i aferave të tij me tendera.

Dosja e SPAK-ut tregoi se Benet Beci, kur ishte në krye të KESH, vetëm në tenderin me vlerë rreth 800 mijë euro për matrapazin Ervis Myftari, ndante pothuajse të gjithë vlerën e tenderit. Në një nga SMS-të e gjetura nga prokurorët e SPAK, duke ju referuar tenderit për strategjinë e sektorit energjetik, Evis Berberi i shkruan Benet Becit: ***“500 mijë euro për profesorët e Harvardit, 320 mijë euro për ne me dy klasë shkollë”***. Beci është marrë i pandehur vetëm për shkelje e barazisë në tendera, ku ka kërkuar gjykim të shkurtuar, ndërsa i ka shpëtuar akuzës së korrupsionit dhe hetimit pasuror.

Nga ana tjetër, Elisa Spiropali është përfshirë në afera të faktuara korruptive, ndërsa dyshohet se fsheh pasuri të paluajtshme dhe të pajustificuara në emrin e prindërve. Në gusht të vitit 2013, disa muaj pasi Partia Socialiste fitoi zgjedhjet parlamentare, **vëllai i Elisa Spiropalit, Enkli Spiropali themeloi në Fier kompaninë Solomon Construction**, me objekt import-eksportin e tregtimin me shumicë e pakice të artikujve të ndryshëm industriale. Në prill 2015, Enkli Spiropali ia shet kompaninë **Marjus Memushajt**, i cili është kushëriri i Salarjon Totajt.

Gjatë kohës kur kompania ishte në pronësi të vëllait të Spiropalit dhe pas kalimit formal në emrin e Marjus Memushajt, rezultoi ka përfutur para publike nga Ujësjetllësi i Fierit kur drejtohej nga Salarjon Totaj. **Në 27 mars 2014, bashkëshorti në atë kohë jo zyrtar i Spiropalit Salarjon Totaj i jep një tender me vlerë 66 mijë euro vëllait të Spiropalit Enkli Spiropali.**

Kompania **Solomon Construction** e themeluar nga vëllai i Spiropalit do të përfundonte në duart e kunatës së saj, **Blerina Totaj**. Në tetor 2021, Marjus Memushaj e shet kompaninë Solomon tek kompania **Fortes Construction për 120 mijë euro**. Duket si një shitje reale, por faktet tregojnë se bashkëshorti i Spiropalit po kalon kompaninë nga njëra dorë e besuar në tjetrën.

Përmes kompanisë **“Solomon Construction”**, Totajt kanë siguruar edhe një kontratë qiraje 90-vjeçare me Ministrinë e Bujqësisë për kultivim ullinjsh në sipërfaqe 19 hektarë në pronësi të shtetit në Patos.

Kompania e projektimit dhe e ndërtimit **Fortes Construction**, e cila bleu kompaninë **Solomon**, është një tjetër linjë biznesi e bashkëshortit të Elisa Spiropalit, Salarjon Totaj. Kompania e themeluar në vitin 2015, me zyra te Shopping Center në Tiranë, është në emrin e dy kunatave të Elisa Spiropalit, **Blerina dhe Luranda Totaj**.

Kompania, e cila operon më shumë si nënkontraktore e firmave që përfitojnë para dhe koncensione publike, qarkullon çdo vit qindra mijëra euro. **Blerina Totaj** rezultoi nyja e interesave të kamufluara të çiftit Elisa Spiropali dhe Salarjon Totaj. Përmes saj, çiftit kontrollon kompaninë e ndërtimit **Fortes Construction** si dhe kompaninë import-eksport të artikujve të ndryshëm industriale Solomon Construction.

Në shtator të vitit 2022, **bashkëshorti i Elisa Spiropalit, Salarjon Totaj**, themelon kompaninë **S T Consulting**, ndryshuar emrin në **SALT**, me objekt shit-blerje pronash një fushë që në raportet e SPAK-ut konsiderohet si më kryesorja për pastrimin e parave. Krahas biznesit privat, Totaj rezultoi njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues të DPSHTRR me pagë rreth 9 mijë euro vit.

(Më herët, Totaj ka qenë drejtor i Ujësjetllësit të Fierit, ku i ka dhënë tendera kunatit (vëllait të Spiropalit), por rezultoi edhe anëtar i Këshillit Mbikqyrës të kompanisë shtetërore të gazit Albgaz si dhe drejtor i Shërbimeve Mbështetëse në Operatorin e Sistemit të Transmetimit OST). Ndërkaq, në vitin 2023, bashkëshorti i zonjës Spiropali deklaroi rreth **40 mijë euro të ardhura nga aktiviteti i kompanisë SALT shpk**.

TAG:

Benet beci

Elisa spiropali

Pastrim parash

Pasuri

takim

Tendera

Skandali në tenderin e KQZ: Si ndërhyri Sekretarja në sistem për favorizuar kompaninë e vëllain e Ferit Hoxhës që hetohet në dosjen e AKSHI-t

Çoi padashje një video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë. Hetuesit u tronditën nga pamjet

Kush është Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të Thaçit dhe pikëpyetjet për zhdukjen e tij

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581 Notice: ob_end_flush(): Failed to send buffer of zlib output compression (1) in /home/prapaskena/public_html/wp-includes/functions.php on line 5581

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.